



LIFE  
**DinPin  
Bear**



## THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

### **Për t'u bërë pjesë e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit Gjenetik të Ariut të Murrmë në Shqipëri**

Ftohen organizatat e shoqërisë civile që kanë në fokus, ose pjesë të veprimtarisë së tyre, mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe veçanërisht ato me eksperiencë në monitorimin e jetës së egër, të shprehin interesin për t'u bërë pjesë e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit Gjenetik të Ariut të Murrmë në Shqipëri.

Organizatat, grupet lokale të veprimit dhe subjektet e tjera të regjistruara që ushtrojnë aktivitet në qarqet **Kukës, Shkodër, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Korçë, Berat** dhe **Gjirokastrë**, ftohen të aplikojnë për t'u përfshirë në këtë nismë. Organizatat e përzgjedhura do të angazhohen në punën në terren për mbledhjen e materialit gjenetik gjate periudhes Shtator – Nentor 2026, duke kontribuar në vlerësimin për herë të parë në shkallë kombëtare të popullatës së ariut të murrmë në Shqipëri.

Kjo nismë zhvillohet në kuadër të projektit rajonal **Life DinPin Bear**, në bashkëpunim me **Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura**.

Organizatat e përfshira do të përfitojnë kompensim financiar për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me aktivitetet në terren dhe, në bashkëpunim me **PPNEA-n**, do të angazhohen në monitorimin e zonave specifike brenda qarkut të tyre.



### **Kriteret e pranueshmërisë:**

Për secilin nga qarqet e sipërpërmendura do të përzgjidhet një organizatë që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të jetë subjekt i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar.
- Të ketë në objektin e veprimtarisë së saj mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit ose faunës së egër.
- Të disponojë staf ose person përgjegjës për koordinimin e ekspeditave studimore.
- Të paraqesë një letër shprehjeje interesi.
- Të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit.
- Disponueshmëri për të kryer aktivitete në terren gjatë periudhës Shtator – Nëntor 2026.

### **Dokumentacioni i kërkuar:**

- Certifikata ose vendimi i regjistrimit të subjektit.
- Letër shprehjeje interesi.
- Të dhënat e kontaktit të organizatës dhe të personit përgjegjës.

*( të gjitha dokumentat preferohen të dorëzohen në formatin PDF )*

### **Linku për aplikimin në google forms:**

<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLScsauDLHGeKrN6gGnr2SeXz9ADIEjiynvEj6rgP1xBtkXJ4bg/viewform?usp=dialog>

### **Afatet:**

Hapja e thirrjes: menjëherë pas publikimit

Afati i fundit për aplikim: **28 Qershor 2026, ora 23:59**

Njoftimi i organizatave të përzgjedhura: **1 Korrik 2026**

**Aplikimet dorëzohen përmes formularit online të shprehjes së interesit.**



LIFE  
**DinPin**  
**Bear**



Co-funded by  
the European Union

